

**2** Lufta kundër dumpingut në paga Në Cyrih zbulohet rasti i madh në Evropë

**3** Zgjedhjet e Parlamentit të BE-së 2019 Festojnë radikalët dhe nacionalistët e djathtë

**4** Marrëveshja e Sigurmeve Shoqërore me Kosovën Përfundimi i pjesërishëm i diskriminit selektiv e ekskluziv

Nr. 4 | qershor 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Greva e grave, 14 qershor 2019:

## Zvicra nuk heshti, ajo u shkundë



Pamje nga demonstrimi madhështor me rastin e grevës së grave me 14 qershor 2019 në Bernë

Osman Osmani

Me 14 qershor 2019 u shkrua histori e Zvicrës. Disa qindra-mijëra gra (dhe burra solidar) morën pjesë në grevën e grave si në ndërmarrje ashtu edhe në rrugë. Kjo është marramendëse! Gjithandej nëpër Zvicër kishte pauza greve, demonstrata dhe në aksione të panumërta të vogla e të mëdha. Një shenjë me zë të lartë, e shumëllojshme dhe e fuqishme, që sa i përket barazisë në Zvicër më në fund duhen përparime dhe se gratë kanë merituar më shumë respekt, më shumë pagë dhe më shumë kohë.

Pas kësaj ditë të suksesshme qëndron shumë punë. Një falënderim i madh shkon tek përgjegjëset e grevës së grave dhe tek koleget e kolegët, të cilët në muajt e fundit kanë mobilizuar gra të panumërta nëpër ndërmarrje dhe aksionet në rrugë si dhe që në bashkëpunim me kolektivitet regjionale kanë organizuar në të gjithë Zvicrën. Një falënderim i madh shkon edhe tek të gjitha ndihmëset e ndihmësit, të cilët ishin në detyrë me 14 qershor: pa ju kjo ditë do të ishte e pamundur në aspektin organizativ. Një falënderim gjigand

për të gjithë ju! Keni bërë një punë të mrekullueshme.

Solidariteti, të cilin ne e kemi përjetuar në këto ditë na bënë krenar dhe na bënë të guximshëm. Është kënaqësi të luftojmë bashkërisht si sindikatë për barazi.

### Unia kërkon

Gratë janë ngopur me ritmin e kërimit sa i përket barazisë dhe kërkojnë të ndërmerren masa të prekshme:

- Paga minimale gjithëpërfshirëse për së paku 4000.– fran-

ga dhe një rritje substanciale tek pagat e ulëta në të ashtuquajturat profesione e sektorë të grave (Përkujdesje, Shitje, Pastrim, Industri e Orëve, Gastronomi, Floktari)

- Fund diskriminimit në paga: Mundësi kontrollësh dhe sanksionimi për ndërmarrjet që bëjnë shkelje.
- Kontrata Kolektive gjithëpërfshirëse të Punës veçanërisht në të ashtuquajturat "sektore grash" (p.sh. shitje, përkujdesje)
- Pensione korrekte pleqërie të (AHV/AVS) që sigurojnë

ekzistencën, pa ngritjen e moshës së pensionimit

- 8 javë pushim atësie, pushim lehonie 18 javësh dhe një periudhë prindërisht prej së paku 24 muajsh
- Orar më i shkurtër i punës, stopim i punës me gatishmëri dhe arritshmi të përhershme
- Pushime të mjaftueshme për përkujdesjen e familjarëve
- Qendra fëmijësh dhe sholla ditore të financuara publikisht
- Dëshminë e parë në vepër punëdhënësit mund ta bëjnë në vjeshtën e sivjetme: Tani duhet rritur pagat e grave!

### Editorial



### Të dashura kolege, të dashur kolegë

Në maj 2019 më është besuar drejtimi i sektorit të migracionit. Unë, pas 10 vitesh angazhim, kthehem përsëri në një sektor "tek rrënjët e mija sindikaliste". Para 15 vitesh, në Unia-n e re, kam bashkë vepruar si sekretar për migracion. Ishte një kohë emocionuese, me plotë inspirim e pasurim mësimesh e përvojash.

Besimi i dhënë më nderon dhe unë jam i kënaqur që me shumë aktivistë sindikalistë vullnetarë dhe një ekip të angazhuar ti përvishemi sfidave. Ky bashkëpunim mes aparatit profesional dhe aktivistëve nga baza duhet të mbetet shembullor.

Këto përvoja tregojnë, që veprimi ynë ka ndikim të drejtpërdrejtë për përmirësimin e gjendjes së anëtarëve tanë. Fjala bie kur ne me 2006 pas një lufte të gjatë të Unia-s më ne fund arritëm të anulojmë vizat-tranzitore nëpër vendet e BE-së për të huajt e shteteve të treta. Nga atëherë anëtarëve tanë nuk u duhej më të pritnin me orë të tëra për një vizë-tranzitore para ambasadave të BE-së.

Klima politike është ashpërsuar. Nxitja e së djathtës kundër migranteve/ëve ka arritur që ksenofobinë ta bëjë përditshmëri dhe të pranueshme në shoqëri. Ligjet, të cilat prekin të huajt janë përkeqësuar e ashpërsuar në masivitet, me pasoja të drejtpërdrejta për shumë anëtarë tanë. Në Zvicër dumpingu në paga është edhe më tej një problem i madh. Në të njëjtën kohë mbrojtja e pagave sulmohet politikisht. Pos kësaj iniciative anuluese e partisë popullore SVP/UDC atakon frontalisht lëvizjen e lirë të personave. Mirëpo, ne të bashkuar do të mund të luftojmë suksesshëm sulmet karshi të arriturave tona dhe vlerave përparimtare. Ne jemi shumë dhe uniteti në shumëllojshmëri është forca jonë!

Hilmi Gashi, udhëheqës i migracionit



## News

## Ti punon në gastronomi apo në pastrim e mirëmbajtje dhe donë të arsimohesh më tej?

**Progredir – një arsimim profesional për migrante në gastronomi dhe në pastrim:**

- Ka vite që ti punon në gastronomi, apo në pastrim?
- Ti donë ti zgjerosh njohurit tua gjuhësore dhe aftësitë tua profesionale?
- Ti dëshiron të arrish diplomimin e njohur profesional në gastronomi apo pastrim?

### I interesuar? Na kontakto neve!

Arsimimi fillon në shtator 2019, zhvillohet në Lozanë dhe Vevey.

Këtu mund të lajmërohesh për tubimin informues ku mund të marrësh informata tjera shtesë:

Unia Vaud, Isabelle Smekens, T 079 515 63 13, isabelle.smekens@unia.ch

ECAP Vaud, Andrea Leoni, T+41 320 13 27, aleoni@ecap.ch, www.progredir.ch

# ECAP

## Të drejtat sindikaliste: Zvicra në listën e zezë

Që nga viti 2004 ILO kërkon që Zvicra të ankorohet në ligjet e saja normat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pushimit arbitrar nga puna, normë të cilën ajo e ka ratifikuar në Marrëveshjen e ILO. Para fillimit të konferencës së ILO-s, e cila me rastin e 100 vjetorit të ekzistimit kryesohet nga ambasadori zviceran Jean-Jacques Elmiger, Zvicra kishte përfunduar në listën e zezë të vendeve, të cilat bëjnë shkelje të konventës së ILO-s. Mirëpo, të martën, kryesia e ILO-s me kërkesë të delegacionit zviceran ka vendosur, të heq Zvicrën nga lista e zezë. Sindikatat e Bashkuara të Zvicrës (SGB/USS) e kanë aprovuar këtë procedurë, pasi kjo paraqet një shans reale, që më në fund e drejta zviceran e pushimit nga puna do ti përshtatet normave të së drejtës ndërkombëtare. Vitin e ardhshëm Zvicra do ti raportoi ILO-s mbi rezultatet e medimit. Pos kësaj Zvicra vullnetarisht do ti nënshtrohet një kontrolli të jashtëzakonshëm të ILO-s, që ka të bëjë me respektimin e të drejtave sindikaliste. SGB/USS do të shoqërojë këtë proces.

## Zvicra ka nevojë për më së paku kate javë pushim atësie

Edhe më tej fëmijët në Zvicër në radhë të parë janë çështje grash. Nëse ata sëmuren, nëna qëndron në shtëpi. Nëse mungon kujdestari i fëmijëve dhe baba nuk mund afatshkurtër të merre përsipër obligimin atëror, nëna organizon zëvendësimin. Dhe në shumicën e familjeve baba punon me orar të plotë, ndërsa nëna pjesëherë apo edhe pa pagesë.

Është e qartë: Nëse Zvicra nuk do të mbete prapa në politikën familjare, duhet se para se fëmijët të bëjë çështje grash – më në fund ti bëjë çështje prindërisht. Sindikatat e Bashkuara të Zvicrës (SGB/USS) e përshëndetë propozimin e komisionit përgjegjës të Këshillit të Kantoneve, që të rregullojë ligjërisht pushimin e paguar për etërit. Por në këtë sesion veror fjala është për një zgjidhje minimale: Zvicra ka nevojë për pushim atësie – dhe atë sipas iniciativës katër javë të plotë e jo vetëm gjysmën, të cilën e parasheh kundërpropozimi i komisionit përkatës të Këshillit të Kantoneve. Për të mundur të gjithë etërit, pavarësisht punëdhënësit, që nga fillimi të jenë pjesë e familjes, të marrin përgjegjësinë për fëmijët e tyre dhe për të mundur të lehtësojnë nënat. Që fëmijët edhe më tej të mos janë çështje grash, por çështje prindërisht. Për të parandaluar një zvarritje të mëtejme të zbatimit, SGB/USS është e pajtimit me propozimin e iniciativës popullore për katër javë, si hap i parë, i cili ligjërisht duhet të ankorohet sa më shpejtë.



# Lufta e sindikatës Unia kundër dumpingut në paga Zbulohet rasti më i madh i dumpingut në paga në Evropë

Në Zvicër puna përkeqësohet gjithmonë e më shumë. Mbrojtja e pagës sulmohet. Unia lufton kundër diskriminimit në paga dhe dëshiron të pengojë përkjekjet për të nxitur punëmarrësit vendorë kundër atyre nga hapësira e Be-së.

Webseite Unia (adoptiert von O. Osmani)

Dumpingu në paga në Zvicër është bërë përditshmëri. Gjithmonë e më shpesh rastet skandaloze të dumpingut në paga zënë titujt kryesore. Kjo është vetëm maja e ajbergut. Dumpingu në paga është një problem në shkallë vendi në shumë degë.

### Punëmarrësit mashtrohen deri në 10 milion

Unia kohë të gjatë ka luftuar e vetme kundër dumpingut në paga tek Goger-Swiss AG. Tek një kontroll i detajuar dhe procedurat e panumërta dëshmojnë, se Unia kishte të drejtë në të gjitha pretendimet! Goger-Swiss AG është përgjegjëse rastin ndër më të mëdhenjtë të dumpingut në paga në vendndodhjen e Cyrihut. Deri në 10 milion ka mashtruar Goger-Swiss AG punonjësit e vet.

### Nevojitet më shumë mbrojtje të pagave

Rasti tregon shumë qartë: Zvicra ka nevojë jo për më pak, porse më shumë mbrojtje të pagave. Sot, duhet të supozojmë se tregu për punën e suvatuësve në vendndodhjen e Cyrihut – që është njëri ndër kantieret më të mëdha të Zvicrës – në fakt ishte i ç fuqizuar si i tillë gjatë viteve të Goger. Më i lirë nuk ishte askush tjetër; praktikisht të gjitha kontratat e mëdha fitimprurëse shkuan tek Goger-Swiss AG. E gjithë kjo në kurriz dhe me pasojë dështuese



Pamje nga aksioni i sindikatës Unia kundër dumpingut në paga

për punëdhënësit korrekt dhe të gjithë punonjësit e Goger.

### Punonjësit e kantieret e komunikacionit publik të Gjenevës janë shfrytëzuar

Pas Cyrihut dhe Tiçinos është prekur edhe Gjeneva nga një rast i rëndë të dumpingut në paga tek komunikacioni publik (TPG). Rreth pesëdhjetë punëtorëve nga Italia jugore një pjesë të pagave të tyre iu shmangën nga llogaritë e tyre bankare. Këto rritje të shkeljeve

tregojnë qartas, se duhet forcuar mbrojtja e pagave në Zvicër.

### Për punë të sigurte dhe me dinjitet

Mbrojtja e pagave dhe të drejtat e punëmarrësve në Zvicër duhet të fuqizohen. Unia do të ushtronte presion përmes aksioneve dhe mobilizimit si dhe do të hetojë e sqarojë pa mëshirë rastet e dumpingut në paga. Të gjithë kanë të drejtë në punë të sigurte dhe me dinjitet.

# Puna e përkohshme dhe prekariteti Sindikatat kërkojnë rregullim të punës temporale

Puna e përkohshme (temporale) në Zvicër ka marrë përmasa shqetësuese: Që nga viti 1995 i gjithë volumi i punës temporale nga 2,6% është pesëfishuar.

Webseite Unia (adoptiert O. Osmani)

Me futjen në vitin 2012 të Kontratës Kolektive të Punës (KKP) për personelin e huazuar çka është e vërteta janë arritur përparime të rëndësishme për të punësuarit temporalë. Sidoqoftë, punëtorët e përkohshëm ende janë të pafavorizuar në krahasim me punëtorët e përhershëm. Ata shpesh fitojnë më pak, janë të eksponuar më shumë rreziqeve aksidentale dhe edhe mundësitë zhvilluese profesionale janë më të këqija.

### Sindikatat kërkojnë kushte të njëjta pune

Në një konferencë për media të Sindikatave të Bashkuara të Zvicrës (SGB/USS) Unia dhe sindikatat tjera kërkuan ndërmarrjen e masave për të përmirësuar pozitën e të punësuarve të përkohshëm. Këta duhet të kenë kushtet e njëjta të punësimit sikur edhe të punësuarit e rregullt. Konfederata dhe kantonet gjithashtu duhet të vendosin kufijtë e

sipërm të prokurimit për pjesën e të punësuarve të përkohshme.

### Puna e përkohshme nuk duhet të bëhet normalitet

Kryetarja e Unia-s Vania Alleva kërkoj në konferencën për media: «Të gjitha degët dhe ndërmarrjet, të cilat kanë një Kontratë Kolektive të Punës, duhet që edhe për të punësuarit » e huazuar« ta zbatojnë atë! » Në të njëjtën kohë ajo tërhoqi vërejtjen nga ajo, që kushtet prekere të punës të mos bëhen raste normale: « Nëse ne punëmarrësve në Zvicër nuk duam t'ua ofrojmë çfarëdo pune, porse edhe punë të mirë dhe të sigurt, përmes të cilës ata do të mund të ndërtojnë ardhmërinë e tyre, atëherë puna e përkohshme nuk duhet të bëhet rast normal, por më shumti të jetë një zgjidhje kalimtare. »

### Edhe për të përkohshmit duhet të vlejë: punë e njëjtë, pagë e njëjtë

Puna e përkohshme është duke u rritur. Që nga viti 1995 volumi i punës së të punësuarve të përkohshëm proporcionalisht është pesëfishuar. A është kjo shprehje e ndryshimit të trendit? A nuk fshihet pas kësaj dëshira për sa më shumë të punësuar në marrëdhënie pune «fleksibile» e të pa obligueshme?



Prekariteti për të punësuarit e përkohshëm (temporal) sa vjen e po rritet

# Ligji për të huajt dhe për integrim Përforcimi i instrumenteve represive

Ligji i ri për të huajt dhe për integrim (AIG/LEI) donë të nxitë integrimin. Në thelb ligji paraqet përditësim të praktikës të deritashme restriktive karshi të huajve dhe në shumë raste dhe në raste të shumta sforcimin e instrumenteve represive, para së gjithash me rastin e vështirësive të parapara financiare si ato faktike, apo edhe ato të mundshme.

Hilmi Gashi, drejtues i migracionit

Ligji i ri për të huajt dhe për integrim (AIG/LEI) ka hyrë në fuqi që nga 1 janari 2019. Ai rregullon posaçërisht të drejtën e qëndrimit për shtetasit që nuk janë nga shtetet e BE/ EFTA (Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë). Për shtetasit e shteteve të BE/EFTA në rend të parë është përcaktuese Marrëveshja për Lëvizjen e lirë të Personave. Ligji i ri përqendron kushtet për dhënie e lejes së qëndrimit vjetor dhe ajo e qëndrimit të përhershme (leja C), duke ndërlidhur ato me «kriteret integruese». Respektimi i rendit dhe sigurisë publike, respektimi i vlerave të kushtetutës federale, kompetencat gjuhësore (vetëm për të rriturit), pjesëmarrja në jetën ekonomike dhe nxënja a fitimi arsimor, janë disa nga «kriteret integruese» që vendosin se a do të jepet leja e qëndrimit dhe leja e përhershme (leja C), apo do të reduktohet ose hiqet tërësisht si dhe nëse do të lejohet bashkimi familjar.

## Bashkimi familjar i kufizuar

Këto kriteret integruese luajnë një rol vendimtar edhe me rastin e bashkimit familjar. Mos përbushja e kriterëve integruese, veçanërisht varësia nga ndihmat sociale, mund të qojë tek kufizimi i bashkimit familjar edhe për vet zvicranet/ët, shtetasit/it e BE-së dhe personave me leje të përhershme të qëndrimit C. E njëjta vlen edhe për rreziqet e mundshme sociale, me ç' rast këtu marrja e përfitimeve suplementare dhe përfitim nga lirim nga premitë e sigurimeve shëndetësore mund të shërbejnë

si indikatorë. Edhe në kohë ka përkeqësime shtesë: afati i bashkimit familjar kufizohet në 14 muaj.

## Humbja apo degradimi i lejeve

Nëse kriteret e integrit sipas AIG/LEI nuk përbushen, atëherë kjo mund të qojë deri tek humbja apo prapa-kthimi i lejes-C të përhershme, apo humbja e lejes-B vjetore të qëndrimit. Humbja mund të ndodhë drejtpërdrejtë pa pasur nevojë të prapa-kthimit. Kjo domethënë, në rast kur dikush nuk mund të dëshmojë «vullnetin për pjesëmarrje në jetën ekonomike» dhe merr ndihmë sociale, duhet të llogarisë se i duhet të lëshojë Zvicrën. Pasi kjo mund të vlerësohet si mungesë e gatishmërisë integruese dhe të gjobet me tërheqje të lejes së qëndrimit. Kjo ndodh sidomos në rastet e theksuara dhe të përhershme të përfitimeve sociale. Heqja e lejes-C së është e mundur edhe pas me shume se 15 vitesh qëndrim.

Me rastin e prapa-kthimit të lejes-C në një leje-B të qëndrimit mund të lidhet një marrëveshje integruese (apo propozim integruar tek qytetarët e BE-së). Pas humbje së leje-B të qëndrimit personi në fjalë duhet të lëshojë Zvicrën.

## Shkëmbimi informativ i autoriteteve

Ligji i ri parasheh, që autoritetet të informohen në mënyrë të ndërsjellët dhe me kërkesë dhe të lejohet e drejta e konsultimit. Këto informata përdoren «për të

matur shkallën e integrit». Informatat, ndër të cilat edhe ato mbi proceset civile e penale, tërheqja e kompensimeve e dëmshpërblimeve dhe ndihmës sociale, përfitimeve suplementare (shtesë) nga sigurimi i pensioneve AHV/AVS apo ai i invaliditetit IV/AI. Rishtas do të kërkohen edhe informata mbi masat disiplinore të autoriteteve shkollore.

## Masa informimi e trajnimi nga sindikata Unia

Edhe pse ligji i ri AIG/LEI ka disa përmirësime (p.sh. parakushtet për një integrim të përshtetshëm në tregun e punës të refugjatëve, kërkuesve të azilit dhe atyre me të pranuar përkohësisht), në shumë pikëpamje paraqet ashpërsim e përkeqësime të dukshme të së drejtës për të huajt. Përforcimi i instrumenteve represive në shumë lami, si bashkimi familjar, humbja e lejes së përhershme me rastin e mos përbushjes së kriterëve integruese, ne si sindikatë Unia do të na preokupojë fuqishëm në periudhën e ardhme. Andaj ne shumë shpejtë do të ofrojmë masa informative e shkollimi nëpër regjione e seksione.minimin e shumëfishtë ndaj migraenteve dhe për të kërkuar dhënies fund të tij. Zvicra duhet të nje diplomat, aftësitë dhe kompetencat e njerëzve me sfond migracioni. Ajo duhet të pranojë shkaqet specifike të arratisjes së grave dhe tu afrojë këtyre grave siguri e mbrojtje nga dhuna dhe shfrytëzimi – Këtu duhet përfshi edhe nënshtrimin ligjit të punës për punën në amvisnit private dhe për ti dhënë fund kushteve të punës pa dinjitet.

## BE: Më 26 maj, 28 kombe zgjedhën Parlamentin e ri Parlamenti i ri bizar i Evropës

450 milion qytetar/e të BE-së kanë votuar, pjesëmarrja në votime ishte e madhe. Rezultatet: radikalët e djathtë dhe nacionalistët festojnë. Edhe të gjelbrit kanë shënuar rritje të fuqishme: Në të kundërtën partitë e mëdha kanë shënuar shkrirje të mëtejme, socialdemokratët ashtu sikur edhe blloku borgjez.

Oliver Fahrni, workzeitung (përshtatur nga Marilia Mendes)

## E djathta e fortë

Ende pa u bërë 18 muaj, kur nacionalistët e djathtë si Marine Le Pen e Francës, apo Matteo Salvini i Italisë, donin të dilnin nga BE-ja. Tani ata hynë pushtetshëm brenda BE-së. Dhe avancuan në vendet e tyre si partitë më të forta. Sikur ultra të djathtët të mos ishin të përçarë, do të mundin që me 170 deputetë (nga 751) të paraqisnin ndoshta grupin më të madh parlamentar të BE-së. Në disa vende kanë

shënuar rritje të lartë votash, deri në 34% Lega e Salvinit. Më shumë se ai ia ka arritur vetëm Viktor Orban i Hungarisë: ky arriti shumicën absolute. Megjithatë marrja e pushtetit nga e djathta ekstreme tani për tani është refuzuar.

## Të Gjelbrit

Katastrofa klimatike dhe fatkeqësitë tjera ekologjike ju kanë dhënë krah të gjelbërve. Në Gjermani me 21% kanë

arritur të bëhen partia e dytë, në Francë çuditërisht e treta. Problemi: Ata ekzistojnë vetëm në pjesën perëndimore të Evropës. Pra, me më së shumti 79 deputetë (përafërsisht 10%), ata do të përfaqësohen në Strasburg. Shumë pakë matur nga mobilizimi i të rinjve, shumë pak për një ndryshim vendimtar të drejtimit ekologjik.

## Ndryshimi social

Tema tjetër vendimtare për kontinentin është ndryshimi përkitazi me sigurinë sociale dhe drejtësinë. Është duke u djegur në të gjitha anët. Por më shumë se 2/3 e deputetëve të rinj ia marrin patin (nderojnë) kapitalizmin-hileqar. Pa si e qysh, mbesin vetëm më pak se 100 deputetë të rinj që angazhohen për një Evropë sociale.

## Shtytja nga rruga

Shtytja për ndryshimet sociale dhe ekologjike duhet të vijë nga jashtë. Nga sindikatat. Dhe nga rruga.



## Kongresi i Bashkimit të Sindikatave Evropiane: Intervistë

### Sindikatat Evropiane duan një Evropë më sociale.

Nga 21 deri më 24 maj në Vjenë u mbajt Kongresi i 14-të i Bashkimit të Sindikatave Evropiane (EGB/CES). Pjesëmarrëse ishin edhe dy konfederata të sindikatave zvicerane SGB/USS dhe Travail.Suisse. Horizonte zhvilloi një bisedë me Marilia Mendes, sekretare për migracion në Unia.

### Marilia, ti ke marrë pjesë si delegatë e SGB/USS në Kongresin e EGB/CES-it. Cila ishte tema kryesore e Kongresit?

Kongresi u mbajt në javën në të cilën që zhvilloheshin zgjedhjet për Parlamentin Evropian, dhe këto, bashkë me pyetjen se si do të orientohet BE-ja pas këtyre zgjedhjeve, ishin ndoshta nga temat kryesore. Brengosja, shkak i sulmit të paralajmëruar të grupimeve të djathta ekstreme e nacionaliste, të cilat duan të janë më fortë të përfaqësuar në Parlamentin e BE-së dhe më pas duan që të shkatërrojnë Evropën sociale, ishte shumë e madhe. Motoja e Kongresit «Një Evropë korrekte për punëmarrës» përshtatet në skenarin politik dhe bashkë-përmbledhte kërkesat tona. Vetëm një BE sociale mund të ngadhënjë frikën në Evropë dhe tu bëjë ballë forcave antidemokratike.

Me këtë rast nuk u harruan sfidat për të ardhmen: Si do të sillemi ne me digitalizimin dhe automatizimin? Si do të duhet të dukej një ekonomi e qëndrueshme dhe cili është roli i punëmarrësve? Edhe barazia gjinore, politika rinore, migracioni ishin tema, që preokupuan delegatët...

### Sa e madhe ishte pjesëmarrja dhe kush morri pjesë në Kongres?

EGB/CES përfaqëson 45 milion anëtarë të 39 vendeve evropiane. Në Kongres morën pjesë mbi 600 delegatë nga gati 90 sindikata të 38 vendeve, si dhe nga 10 federata të degëve ekonomike. Kishte delegatë të sindikatave që nga perëndimi (p.sh. Irlanda) deri në lindje (p.sh. Turqia), që nga jugu (p.sh. Portugalia) deri në veri (p.sh. Finlanda). Është folur dhe përkthyer në 14 gjuhë evropiane. Pos tjerash ishin pjesëmarrës edhe 400 mysafirë, para së gjithash Bashkime Sindikatash amerikane, kanadeze dhe amerikano-latine.

### A pati vendime, të cilat kanë rëndësi të veçantë për sindikatat zvicerane?

Jo në parim. Bashkimet e Sindikatave Zvicerane kanë marrë mbështetje të konsiderueshme vitin e kaluar nga sindikatat e BE-së sa i përket Marrëveshjes kornizë dhe respektimin e masave mbrojtëse. Qëndrimi i qartë i Kongresit e vërteton këtë linjë.

Një vendim i Kongresit ishte i dhimbshëm fjala bie për komisionin e pensionistëve tanë. FERPA është federata e pensionistëve dhe disa nga anëtarët tanë janë mjaft aktiv aty: FERPA nuk ka të drejtë vote në EGB/CES. Për disa herë është parashtruar kërkesë për të drejtën e votës, e e cila mjerisht është refuzuar. Kjo ishte e bezdisshme, pasi pensionistët japin një kontribut të rëndësishëm dhe përfaqësojnë preokupime me rëndësi shoqërore. Ne shpresojmë, që pas katër vitesh kongresi të vendos ndryshe.

### Përderisa kapitali dhe ndërmarrjet veprojnë globalisht dhe posedojnë një lob politik «solidar», krijohet përshtypja, që sindikatat operojnë para së gjithash në rrafshin lokal apo nacional dhe i kushtojnë pak rëndësi aspektit internacionalist. Se e vlerëson ti bashkëpunimin sindikalist në përgjithësi?

Qëndron, që ne shpesh kemi ndjenjë, jemi të orientuar kah vetja dhe në kufijtë kombëtar. Ndërsa kemi me miliona punëmarrës me shqetësime e preokupime të njëjta dhe shumë sindikata, që punojnë për çështje të njëjta. Ne mund të mësojmë shumë nga njëri tjetri dhe shumëçka të bëjmë bashkë. Megjithatë ka më shumë punë ndërkombëtare se sa mendohet. Në shembull është solidariteti i sindikatave evropiane me luftën tonë për ruajtjen e masave mbrojtëse. Ne vet tek Unia jemi duke u përpjekur, të orientohemi në punën ndërkombëtare. Në Kongres aspekti internacionalist ishte mirë prezent. Mirëpo është e qartë, që kemi nevojë për shumë më shumë bashkëpunim e koordinim ndërkombëtarë.

### Dhe së fundi: Cili është përfundimi i Kongresit të EGB/CES dhe përshtypja jote e përgjithshme?

Që BE duhet të bëhet më sociale duhet të përfaqësoj me pak interesat e punëdhënësve dhe kapitalit, po has gjithnjë e më shumë përkrahje. Bartësi i çmimit Nobel me këtë rast ka përmblidhë rolin e sindikatave: Bota e punës mbizotërohet nga pabarazia dhe kjo është shkatërruese për demokracinë; Sindikatat janë bastion kundër fuqive shkatërruese. Kjo neve na jep shumë përgjegjësi, mirëpo edhe mundësinë, që të punojmë në ndryshime pozitive: Për më shumë drejtësi, të drejta të njëjta dhe barazi shansesh për punëmarrësit dhe për të dobëtit e shoqërisë. Kjo ndërlidhë sindikatat. Kjo ndjenjë e përbashkësisë me kaq shumë njerëz me sfonde të ndryshme i takon më të bukurës, që njeriu mund të përjetojë në një Kongres të tillë. Kjo mua më jep sigurinë, që është e mundur një botë e shumëllojshmërisë dhe se ia vlen të angazhohesh për te.

Osman Osmani



Në zgjedhjet e majit 2019 për Parlamentin e ri të BE-së u forcua e djathta ekstreme

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Mëditja (pagesa ditore): A mbesin në rast sëmundjeje borxh zbritjet sociale?

Para një kohe jam sëmurë seriozisht, për këtë shkak edhe i paaftë për punë. Përmes firmës sime jam i siguruar për marrjen e mëditjes në rast sëmundjeje. Me rastin e kontrollimit të listës së pagës pash se shefi im nga mëditja në rast sëmundjeje mi kishte bërë heqjen edhe të kontributeve për sigurimet shoqërore (AHV/AVS, IV/AI, EO/APG), sigurimin e papunësisë dhe arkën pensionale si dhe premitë për aksidente joprofesionale (NBU/ AANP) dhe për sigurimin e mëditjeve në rast sëmundjeje. A guxon ai të bëjë këtë?

**David Aebly:** Jo. Mëditjet e të siguruarve në rast sëmundjeje nuk janë pagë që i nënshtrohen detyrimit kontribues, andaj nuk mbesin borxh të kontributeve për AHV/AVS, IV/AI, EO/APG, SUVA (NBU/ AANP). Mëditjet në rast sëmundjeje nuk janë pagë, të cilën e paguan firma, por zëvendësim page, të cilin e paguan sigurimi. Sipas rregullit, kjo domethënë, që ju nuk duhet të paguani as premi të sigurimit të mëditjes, pasi premitë e sigurimit aktualisht i nënshtrohen obligimit kontribues. Nëse një firmë, krahas parave të sigurimit paguan shtesë një përqindje të pjesës së pagës, kjo i nënshtrohet obligimit kontribues. Ky vlen gjithashtu edhe në rasti e pagesës ditore (mëditjes) të shtyrë: Nëse pra firma paguan të 30 ditët e para të sëmundjes apo aksidentit, sigurimi merr përsipër pagesën nga dita e 31-të. Pra, përfitimet e pastra të sigurimit përjashtohen nga detyrimi i kontributit. Nëse ekziston një përjashtim premie për fondin pensional varet nga rregulloret përkatëse të fondit.

Work, 31.5.2019

### Invaliditeti: A guxon arka e papunësisë të shkurtorjës mëditjet (pagesën ditore)?

Kohë të shkurtër pasi humba vendin e punës, pësive edhe një aksident të rëndë: Ankesat janë aq të forta dhe zgjasin aq shumë, sa që unë u detyrova të lajmërohem tek sigurimi i invaliditetit. Ky tani ma ka aprovuar një gjysmë pensioni i invaliditetit. Që nga kjo kohë, Arka e Papunësisë donë të më shkurtorjës të ardhurat e siguruar dhe me këtë edhe mëditjet (pagesën ditore) përkatëse. A guxon Arka e Papunësisë të bëjë këtë?

**Nicole Debrunner:** Po. Veprimi i Arkës së Papunësisë është korrekt. Detyrimi i sigurimit të papunësisë për të paguar kufizohet në aftësinë e mbetur për punë të personit të siguruar. Nëse një person, pak para apo gjatë papunësisë bëhet invalid, kështu aftësia për punë nuk i përgjigjet asaj të para papunësisë. Si bazë për përllogaritje të mëditjes shërben fitimi para invaliditetit. Ju merrni nga IV/AI një gjysmë pensioni, gjë që përsëri domethënë, se ju jeni 50% i aftë për punë. Andaj, Arka e Papunësisë i ka përshtatur të ardhurat e siguruar. Përshtatja pason nga muaji, nga i cili fitohet e drejta për pension i invaliditetit. Megjithatë pensioni i invaliditetit përshtatë reduktimin e kompensimit nga sigurimi i papunësisë.

Work, 26.4.2019

### Cilat dokumente duhet të dorëzoj për të ardhura të ndërmjetme?

Kam punuar si kopshtar dhe kam humbur punën më 1 tetor 2018. Një i njohur ka një kompani të kopshtarisë. Atje kam mundësi që përkohësisht të punoj si kopshtar për dy ditë në javë. A mund ta bëj këtë? Dhe çfarë duhet të marr parasysht?

**Markus Widmer:** Po, mundeni. Meqenëse paga juaj është më e vogël se kompensimi mujor i papunësisë, është një e ardhur e ndërmjetme. Këto të ardhura të ndërmjetme duhet ti lajmëroni tek këshilltari juaj i RAV (Zyra regionale për ndërmjetësim të punës) dhe të pyetni atë, se a duhet reduktuar numrin e aplikimeve për punë. Arkës suaj të Papunësisë duhet ti dërgoni një kopje të kontratës së punës. Për çdo muaj, përpos formularit «Të dhënat për personin e siguruar», duhet të dorëzoni edhe dy formularë tjerë. Atë për të ardhurat e ndërmjetme të plotësuar nga punëdhënësi si dhe një listë page. Vini re ju lutem, se Arka e Papunësisë mund tua paguajë mëditjen tek kur ajo ti ketë të gjithë formularët. Po që se nuk keni, apo keni pak kursime dhe jeni të varur nga mëditja, ne ju sugjerojmë si në vijim: Luteni punëdhënësin e juaj, që formularin «Vërtetimi për të ardhurat e ndërmjetme» ta plotësojë shpejtë çdo fund muaji dhe tua jap juve. Dërgojeni këto dokumente tek qendra e skanimit përgjegjëse për ju. Posa punonjësit e Arkës së Papunësisë të shohin se janë të skanuara dokumentet e nevojshme për pagesën tuaj, mund të ju paguhen mëditjet e muajit përkatës.

Work, 1. März 2019

## Marrëveshje për sigurimet shoqërore Të kthyerit e Kosovës mund të llogarisin në pension

Kosova është shteti i vetëm pasues i ish – Jugosllavisë, me të cilat Zvicra nuk ka marrëveshje nga fusha e sigurimeve shoqërore. Në dëm të shumë të kthyerve në Kosovë, të cilët edhe humbën të drejtën për një pension. Kjo duhet të ndryshojë tani.

Nga Peter Siegenthaler, swissinfo.ch, 21 mars 2019 (shqipëroi O. Osmani)

Ata punuan për vite në Zvicër dhe paguan kontributet në sigurimet e detyrueshme shoqërore, por kur erdhi radha e tyre për të marrë një pension të pleqërisë ose invaliditeti për të kaluar moshën e tyre të pensionimit në vendin e tyre, ata mbetën duarbosh.

Fjala është për mijëra kosovarë, të cilët në gati 10 vitet e fundit u diskriminuan financiarisht për shkak se Zvicra në vitin 2010 vendosi të mos për të vazhduar Marrëveshjen e sigurimeve shoqërore me ish – Jugosllavinë Sociale Sigurimit në raport vetëm me Kosovën.

Këshilli Federal në atë kohë si justifikuar këtë hap si në vijim: «Marrëveshja e sigurimeve shoqërore shërben për koordinim të sistemeve shtetërore. Kontraktimi i tyre ka si parakusht sistemet funksionale të dy Shteteve Kontraktuese.» Me çka domin të thoshin se: në Kosovë nuk funksionin një sistem i tillë.

### Pension vetëm në rast vendbanimi në Zvicër

Shtyja për prishjen e marrëveshjes ka qenë një mocion parlamentar i Partisë Popullore Zvicerane (SVP), e cila donte të udhëzonte Këshillin Federal që «të prishë të gjitha marrëveshjet për sigurimet shoqërore me shtetet pasuese të ish-Jugosllavisë, përkatësisht për të mos i rinegociuar ato.» Gjë që qeveria federale, përveç në rastin e Kosovës, e refuzoi.

Për kosovarët, vendimi nënkuptonte se ata do të merrnin pensionet e tyre vetëm nëse ata kishin vendbanim në Zvicër. Mirëpo, shumë prej tyre kishin ndjekur apelet e autoriteteve zvicerane, të cilët pas luftës sugjeruan kthimin në atdhe madje edhe duke mbështetur ata.

«Kjo ishte një diskriminim selektiv», thotë Osman Osmani nga sindikata UNIA, e cila në bashkëpunim me diasporën kosovare kërkonin vazhdimin e zbatimit të Marrëveshjes ekzistuese deri në përfundimin e një të reje.

«Ndërkohë që disa prekur kanë vdekur, gratë e tyre të veja që kanë rritur fëmijët, bashkë me jetimët kanë mbetur gjithashtu»

### Diaspora e dytë më e madhe

Zvicra ka diasporën më të madhe të shqiptarëve të Kosovës pas Gjermanisë. Në Zvicër jetojnë rreth 112 000 njerëz me shtetësi kosovare. Megjithatë, numri i njerëzve që vijnë nga shteti më i ri i Evropës është shumë më i madh. Sipas një studimi nga Zyra Federale e Statistikave në vitin 2015, gati 250 000 njerëz e deklaruan gjuhën shqipe si gjuhë të tyre kryesore - shumica prej tyre nga Kosova.

Zvicra njohu Republikën e re të Kosovës më 27 shkurt 2008 dhe krijoi marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore me Kosovën. Që atëherë, Zvicra dhe Kosova kanë lidhur marrëveshje dypalëshe në fushën e bashkëpunimit teknik dhe financiar, avionit civil, transportit të udhëtarëve dhe mallrave përmes mbrojtjes së rrugëve, tregtisë dhe investimeve.

swissinfo.ch



Pamje nga aksioni i majit 2010 para pallatit federal me rastin dorëzimit të peticionit

htu duarbosh. Edhe fëmijët e të rinjtë që vijonin shkollimin Ishin në mesin e viktimave, për shkak se askush nga ta nuk vazhduan të merrnin shtesat për fëmijë apo ato të arsimimit,» venë në pah sekretari sindikal.

Argumentet e Këshillit Federal të atëherëshëm nuk janë të vlefshme për të. «Për dallim nga Marrëveshja e sigurimeve shoqërore, Zvicra po në vitin 2010 tashtë ka lidhur marrëveshje të tjera me Kosovën, për shembull atë kthimit dhe atë mbi partneritetin e migracionit.»

### Pse jo si Gjermania?

Sikur të kishte ekzistuar një vullnet i mirë, do të mund të gjendej mënyra për përfituar pensionet të siguruarit në Kosovë, thotë Osmani, duke pasur parasysh vende tjera evropiane. Për shembull, Gjermania gjatë gjithë këtyre viteve ka vazhduar tu paguaj më tej kosovarëve të kthyer pensionet e tyre legjitime dhe madje u ka dhënë mbështetje financiare autoriteteve zbatuese atje.

Osmani nuk pranon arsyetimin se personat gëzonin të drejtën të kërkonin kthimin e kontributeve të tyre të paguara. «Ky nuk është qëllimi i sigurimeve shoqërore, pasi kontributet janë ndaluar për të siguruar një jetë me dinjitet me rastin e daljes në pension të pleqërisë ose paaftësi, andaj për këtë arsye shumë kosovarë të pensionuar edhe kanë refuzuar të kthehen në vendin e tyre të origjinës.»

Diaspora kosovare është e konsiderueshme. Sot, më shumë se 200 000 njerëz me rrënjë nga Kosova jetojnë në Zvicër. 110 000 janë kthyer në vitet e fundit në shtëpi. Privimi nga e drejta e përfitimit prek disa mijëra njerëz, vlerëson Osmani. «Nga viti 2010 deri më sot, shtetasit e Kosovës për shkak të shqetësimit ekzistencial 6000 shtetas të Kosovës kanë tërhequr kontributet e tyre nga sigurimi i pleqërisë (AHV/AVS), ndërsa të tjerët që kanë të drejtë në përfitime ka 9 vite që janë duke pritur për pensionet e tyre të merituar.»

### Aprovimi pothuajse i padiskutueshëm

Tani Zvicra ka negociuar një marrëveshje të re të sigurimeve shoqërore me Kosovën. Dhoma e vogël e Parlamentit (Ständerat) të enjten e 21 marsit 2019 e

miratoi atë me 38 vota për 1 votë kundër dhe 0 abstenime.

Një raport mbi gjendjen e sundimit të ligjit dhe korrupsionit ka treguar se tani kushtet në Kosovë janë përmëshur përsëri për të hyrë në këto marrëdhënie, tha Pirmin Bischof, zëdhënësi i komisionit përgjegjës.

Edhe pothuajse të gjithë këshilltarët e SVP-së, partia e të cilëve në vitin 2009 kishte bërë thirrje për përfundimin e marrëveshjes së vjetër me referenca për abuzime të supozuara u pajtuan që marrëveshja të miratohet.

«Unë jam i mendimit dhe besoj se punëtorët dhe punëtorët i meritojnë përfitimet nga rrafshi i sigurimeve shoqërore dhe nëse u lejohet të marrin këto para në atdhe, ata/o me pensionin nga Zvicra do të kenë një jetë të mirë në Kosovë», thotë për swissinfo.ch këshilltari i SVP Roland Eberle.

Zvicra madje përfiton financiarisht nga kjo: «Nëse nuk u jepet kjo mundësi dhe ata duhet të qëndrojnë në Zvicër dhe pensionet e tyre janë tepër të ulëta për të mbuluar koston e jetesës, ata do të kenë nevojë për shërbime publike shtesë.»

Kthesën e partisë së tij, Eberle e shpjegon me arsyetimin se strukturat administrative në Kosovë sot punojnë më mirë. «Ne nga administrata federale, e cila ka negociuar Marrëveshjen ndër-shtetërore, na ka siguruar besueshëm, që pensionet në Kosovë do të arrijnë tek përfituesit». Kjo më parë ishte testuar përmes një pilot projekti në dhjetëra raste.

Nëse në seancën e verës, edhe dhoma e madhe parlamentare (Nationalrat) gjithashtu i thotë po Marrëveshjes, ajo mund të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2020. Atëherë gjithçka për mrekulli? Jo krejtësisht: Kush nuk ka marrë një pension në dhjetë vitet e fundit, nuk do të kompensohet për këto vite të shkuara. Nuk është parashikuar një kompensim retroaktiv i përfitimit. «Për ata që janë të prekur është një »fat i keq", thotë Eberle.

Sindikalisti i Unia, Osmani nga ana tjetër, bënë thirrje për një zgjidhje e cila mundëson të drejtën e përfitimit edhe për periudhën kohore që nuk është zbatuar Marrëveshja. «Përndryshe, edhe përkundër korrigjimit, do të mbetet një njollë të errët në këtë çështje.»